VENDIM
Nr.92, datë 26.9.2011

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË LICENCËS NR.63 TË DHËNË ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE NR.89, DATË 6.8.2008, TË NDRYSHUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 19, DATË 8.3.2010 PËR "ALBANIAN GREEN ENERGY"

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1 germa "a", dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.9.2011, pasi shqyrtoi informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë "Albanian Green Energy" sh.p.k.,

dhe duke konsideruar:

Kompleksitetin e problematikës që i licencuari ka hasur për fillimin e punimeve për ndërtimin e centraleve, TEC me biomasë të lëngshme, për shkak se ende nuk ka marrë autorizimin final të ndërtimit të kësaj linje nga Ministria e Ambientit dhe Mbrojtjes së Territorit të Detit në Itali, duke qenë se ndërtimi i linjave të interkonjeksionit, përveç etapave administrative në të cilat kalon çdo projekt përbën akoma një teknologji jo shumë të njohur në vend dhe që kërkon asistencën teknike të huaj,

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.89, datë 6.8.2008, për dhenien e licencës shoqërisë "Albanian Green Energy" sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike (Bllok motorë - gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme Shëngjin, Lezhë) të bëhen këto ndryshime:

Pika 1 germa "d" të ndryshohet si më poshtë:

"d.1. Afati i fillimit të punimeve për realizimin e projektit do të jetë në përputhje të afatit të përcaktuar në lejen e METE-s nr.4/1, datë 7.12.2009, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.31, datë 20.1.2010, të ndryshuar, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.542, datë 27.7.2011 për ndërtimin e linjës tregtare të interkonjeksionit me rrymë të vazhduar ndërmjet Kallmet/Lezhë dhe Zapponeta/Manfredonia.

d.2. Koha e zbatimit të gjithë projektit, përfshirë dhe kolaudimin e veprës, do të jetë 36 muaj nga realizimi i afatit të përcaktuar në pikën d.1.".

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë "Albanian Green Energy" për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani